

Data: 10.10.2023

Vendi: Akademia Tempulli

Takimi i komitetit të programeve me këtë

## REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Kalueshmëria e studentëve ne afatin e Shtatorit
3. Miratimi i syllabuseve për semestrin dimëror të vitit akademik 2023/24
4. Fillimi procesit mësimorë dhe oraret mësimore të semestrit dimëror për vitin akademik 2023/24,
5. Të tjera.

Mbledhja do të mbahet me datën 10 Tetor 2023 në orën 10.00.

Koordinatorët:

Dr.Sc. MevlanBixhaku dhe Msc. Adem Selmani

---

Nga mbledhja e Komiteti të programit të mbajtur me datë 10.10.2023, në Akademi duke filluar prej orës 10:00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Mevlan Bixhaku Koordinator i programit master,
2. Msc. Adem Selmani, Koordinator i programit bachelor,
3. Dr. Sc. Muhamed Krasniqi, staf akademik, drejtor ekzekutiv,
4. Dr.Sc. Astrit Sallauka, staf akademik,
5. Dr.Sc.Habib Hasani, staf akademik,
6. Dr.Sc. Flamur Salihu, këshilltar I jashtëm,
7. Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi, staf akademik,
8. Dr. Fevzi Berisha, staf akademik,
9. Msc. Shpresa Ibrahim, staf akademik,
10. MSc. Sami Mazreku, staf akademik,
11. Dr.Sc. Eflorim Hajra, staf akademik,
12. Msc. Fatime Krasniqi Sekretarja e Përgjithshme e Akademisë,
13. Arsim Zagragja, nga rendi studentor
14. Nazmi Gashi, nga rendi studentor,
15. Blerina Dragusha, asistente administrative.

Mbledhjen e hapi Koordinator i Dr.Sc.Mevlan Bixhaku i cili i falënderoi për prezencën dhe propozoi për miratim këtë:

#### REND DITE

- I. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- II. Kalueshmëria e studentëve ne afatin e Shtatorit
- III. Miratimi i syllabuseve për semestrin dimëror të vitit akademik 2023/24
- IV. Fillimi procesit mësimorë dhe oraret mësimore të semestrit dimëror për vitin akademik 2023/24,
- V. Të tjera.

Rendi i ditës u aprovua unanimisht nga të gjithë pjesëmarrësit e Komiteti të Programit.

### **I. Miratimi i ekstraktit nga mbledhja e kaluar**

Koordinatorët e programit hapën diskutimin për miratimin e ekstraktit të mbledhjes së kaluar. Pasi që nuk kishte ndonjë sugjerim apo ndryshim atëherë në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e komitetit të programeve u aprovua ekstrakti nga mbledhja e kaluar.

### **II. Kalueshmëria e studentëve në afatin e Prillit dhe Qershorit,**

Në pikën e dytë sipas agjendës u diskutua për kalueshmërinë e studentëve në afatin e Shtatorit për vitin akademik 2022/2023. Nga prezantimi i bërë nga z. Bixhaku për të pranishmit, ishte mendim i përbashkët që afati i Shtatorit ka kaluar pa probleme, dhe se kalueshmëria ishte në nivel të kënaqshëm, me një përqindje të kalueshmërisë mbi mesatare. Gjithashtu u diskutua që nëse studentëve u paraqiten probleme të kalueshmërisë në lëndë specifike të organizohen orë shtesë në mënyrë kalueshmëria të mbahet në nivele të kënaqshme.

### **III. Miratimi i syllabuseve për semestrin dimëror të vitit akademik 2023/24**

Në pikën e tretë të rendit të ditës u hap diskutimi i syllabusëve për vitin e ri akademik 2023/24. U diskutua për ndryshim/plotësimet e syllabusëve të cilat secili mësimmëdhënës i ka bërë sipas nevojës së lëndës. Në parim të gjithë syllabusët janë të gatshëm dhe miratohen për semestrin dimëror të vitit akademik 2023/24. Lidhur me këtë pikë Znj. Sara Fusha Osmani, zyrtare e cilësisë kërkojë nga stafi akademik që të jenë më të kujdesshëm tek çështja e kopjimit nga ana e studenteve, dhe të njoftohen me dy rregulloret e masave disiplinore të cilat janë të vendosura në MOODLE, se mund të ketë ndëshkime sipas rregulloreve, për ata studentë të cilët nxihen duke kopjuar. Po ashtu nga stafi u kërkuar që në javën e parë dhe eventualisht edhe në javën e dytë pasi të fillojë procesi mësimorë, të prezantohet syllabusi nga mësimmëdhënësit për studentët, në mënyrë më të detajuar, dhe të nxiten për një vijueshmëri më të lartë, në ligjërata, pasi edhe vlerësimi i tyre do të bëhet në pajtueshmëri me syllabusin e lëndës. Njëri nga përfaqësuesit e studentëve Z. Nazmi Gashi, kërkojë që pyetjet në testet në kollokviume dhe provimet finale të jenë pak më ndryshe, dhe jo vetëm në

formën e sistemit a), b), c), pasi kjo do të krijonte një vlerësim më real dhe do të zvogëlonte në masë të madhe mundësin e kopjimit.

#### **IV. Fillimi procesit mësimorë dhe oraret mësimore të semestrit dimëror për vitin akademik 2023/24,**

Në pikën e katërt të rendit të ditë, të pranishmëve ju drejtua Sekretarja Znj. Fatime Krasniqi, e cila i njoftoi të pranishmit lidhur me fillimin e procesit mësimor, i cili pritet të fillojë javën që vjen, pasi të jetë rregulluar çështja e aranzhimit të ligjëruesve për lëndët përkatëse. Lidhur me këtë çështje Znj. Shpresa Ibrahim, ligjëruese, kërkoi që përfaqësuesit e studentëve nga parlamenti studentor, gjatë javës së parë dhe të dytë të ligjëratave, të caktojnë një orar, gjatë të cilit do të mund të ofrojnë konsulta lidhur me procesin mësimor për vitin e ri akademik 2023/2024, për studentët e ri. Një mundësi e cila mbet të shqyrtohet. Lidhur me këtë pikë fjalën e morri edhe Z. Astrit Sallauka, ligjërues, i cili kërkoi nga kolegët që gjatë orëve të para në vitin e ri akademik, përveç syllabuseve ti kushtohet më shumë rëndësi gjetjes së mënyrës për ti stimuluar studentët që të jenë më shumë prezent gjatë ligjëratave, dhe mundësisht nëse ka një mundësi që të gjendet një zgjidhje për çështjen e telefonave të studentëve si gjatë ligjëratave ashtu edhe gjatë provimeve.

Diskutime tjera nuk kishte dhe mbledhja përfundoi në ora 11:15.

Adem Selman, Koordinator i programit Bachelor

*Adem Selmani*

Mevlan Bixhaku, Koordinator i programit Master

*Mevlan Bixhaku*

---